



Emiliano Mankolli, *pedagog* në universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu”, në Shqipëri, *data scientist* dhe *machine learning ekspert* në Ritech Group of Companies, dhe aktualisht kandidat *PhD* në Akademinë Bullgare të Shkencave në Sofje.

Ai mbaroi studimet Bachelor në degën *Inxhinieri Matematike Informatike* në universitetin e Tiranës në 2012. Pas kësaj, ai ndoqi një program Master në të njëjtin drejtim dhe në të njëjtin universitet, në të cilin u diplomua me rezultate të shkëlqyera.

Menjëherë pas diplomimit, në 2014, atij iu ofrua një pozicion pune si *lektor* në universitetin “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, ku ai ka shpjeguar lëndë të ndryshme si: *Algoritmikë, Sisteme Shfrytëzimi*, and *Analizë të dhënash* etj.

Që prej 2019, ai është duke ndjekur studimet PhD në Akademinë Bullgare të Shkencave në Sofje me fokus “*Metodat e optimizimit për aplikimet e Machine Learning*” me udhëheqës Assoc. Prof. Vassil Guliashki. Fushat e tij kërkimore të interesit përfshijnë (por nuk janë të kufizuara): Inteligjenca e Biznesit, Optimizimi, Automatizimi, Vendimmarrja, Modelimi Matematik, Parashikimi përmes Serive Kohore dhe Machine Learning .

Puna e parë në industri ishte në 2016 si një *data scientist* në PaperClicks, Tiranë, ku ai zhvilloi një algoritëm që automatizon procesin e optimizimit të fushatave të reklamimit në internet. Që nga Marsi i vitit 2019, ai po udhëheq ekipin e Data Science dhe Machine Learning në Ritech Group of Companies, ku ai ka qenë duke punuar në projekte të ndryshme që përfshijnë Natural Language Processing dhe Computer Vision.